



Republika e Kosovës - Republika Kosova	
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica	
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrativë	Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
021 NrJBr 410161-6527	
Data 16.02.2019	
Gjakovë - Djakovica - Gjakova	



Komuna e Gjakovës

Fondacioni "Arku"

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me datë: 11.02.2019, ndërmjet:

- 1.Komunës së Gjakovës, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini, në tekstin vijues "Komuna";
- 2.Fondacionit "Arku" (Organizatë Jofitimprurëse), të cilën e përfaqëson znj. Rovena Dilo, në tekstin vijues "Arku";

Neni 1 Qëllimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim angazhimin e përbashkët për organizimin e aktivitetit kulturor – artistik "*2 zemra që rrabin si 1*" me rastin e shënimit të 17 Shkurt-it ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Neni 2 Përshkrimi i Organizatës

Organizata është krijuar me 29 dhjetor 2016. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar shumë projekte artistike si: "Pushteti i Karriges", "UP Side Down", "Be Different", "Diva Live Show" etj, të realizuara me shumë suksese gjithëpërfshirëse.

Neni 3 Obligimet e Komunës

3.1 Komuna e Gjakovës do të siguroj mjetet finançare në vlerë prej 10.500.00 euro për përkrahjen e aktivitetit Artistik / Kulturore, të paraparë sipas agjendës së Arku-t.

3.2 Mjetet që do të ndahen për organizimin e aktivitetit, do të ekzekutohen pas mbajtjes së aktivitetit, pas pranimit të saturave, kontratave, arsyeshmërive të shpenzimeve të cilat do të jenë të argumentuara nga Fondacioni Arku në bazë të shpenzimeve të parapara.

3.3. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që pas pranimit të gjitha saturave që pasqyrojnë shpenzimet e bëra nga organizata "Arku" dhe pas rekomandimit të Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë financiare të Zyrës së Kryetarit të Komunës të fillojë procedurat e ekzekutimit të pagesës. Shpenzimet do të realizohen nga kategoria mallra dhe shërbime nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 4 Obligimet e "Arku-t"

4.1 Obligohet të sjellë saturat, kontratat origjinale, arsyeshmëritë e shpenzimeve përmes së cilave do të pasqyrohen shpenzimet e bëra, lidhur me aktivitetin e shënimit të ditës së pavarsisë së Kosovës, organizuar në Gjakovë.

4.2 Të gjitha faturat duhet të dorëzohen në organet e administratës komunale së bashku me illogarinë bankare.

Neni 5 Realizimi i aktivitetit

5.1 Realizimi i këtij aktivitetit nga Arku, fillon me datën 17.02.2019 dhe përfundon në të njëjtën datë.

Neni 6

6.1 Ky memorandum i bashkëpunimit është i përpiluar në 3 (tre) ekzemplarë të njëjtë, prej të cilave nga një ekzemplarë u dorëzohen palëve kontraktuese, ndërsa, 1 (një) ekzemplarë i dorëzohet Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkrues, të cilat zotohen se të njëtin do ta zbatojnë në përpikmëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

Palët

Komuna e Gjakovës

Ardian Gjini



Fondacioni "Arku"
Rovena Dilo

